


▶ VAZHDON REGJISTRIMI PËR PJESËMARRJEN NË SAMITIN E DYTË TË DIASPORËS




▶ GJATË QËNDRIMIT NË SHQIPËRI NË DITËT E SAMITIT TË DIASPORËS DO TË KENI MUNDËSI TË EKSPLORONI VENDIN. NË LINK-UN E MËPOSHTËM MUND TË GJENI DISA PROPOZIME PËR ATRAKSIONET NË TIRANË DHE NË LEZHË




▶ PËR AKOMODIMIN NË HOTEL GJATË SAMITIT TË DYTË TË DIASPORËS MUND TË KONSULTONI DHE TË REZERVONI NË LINK-UN:




AGJENCIA KOMBËTARE E DIASPORËS

FONDI SHQIPTAR PËR ZHVILLIMIN E DIASPORËS

QËNDRA E BOTIMEVE PËR DIASPORËN

#4

PËRFAQËSIMI DHE NXITJA E POLITIKAVE TË BASHKËPUNIMIT DHE TË NDËRVEPRIMIT ME TË GJITHË SHQIPTARËT, DUKE NXITUR E FUQIZUAR BASHKËPUNIMIN NË TË GJITHA FUSHAT ME SHQIPTARËT JASHTË KUFIJVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE SHTETET KU ATA BANOJNË

## Këshilli Koordinues i Diasporës, propozimet zyrtare për kandidatët

Këshilli Koordinues i Diasporës ka tashmë listën me kandidatët zyrtarë që do të jenë pjesë e tij, listë kjo e propozuar nga ministria e Europës dhe Punëve të Jashtme.

Nisur nga rrethanat e mbajtjes së Samitit të Dytë të Diasporës si dhe për të pasur një konsultim më të gjerë për këtë çështje në mbledhjen e Komitetit Shtetëror me propozim të Ministrit të Shtetit për Diasporën u gjykua që vendimmarrja të merret pas komunikimit dhe vlerësimit me pjesëmarrësit e Samitit për këtë çështje.

Kandidaturat, të përzgjedhura sipas procedurave ligjore dhe të propozuara nga ambasadat e akredituara jashtë vendit, do të përzgjidhen në një fazë të dytë, pas komunikimit dhe vlerësimit të pjesëmarrësve të Samitit.

Për herë të parë, Këshilli Koordinues i Diasporës do të institucionalizojë prezencën e Diasporës në nivelin më të lartë shtetëror.

> Klikoni ketu qe të lexoni të plotë listën me kandidaturat <







## Publikohet revista e transparencës së Samitit të Dytë të Diasporës

Informacionin e plotë mbi realizmin e Samitit të Dytë të Diasporës mund ta lexoni të plotë në publikimin "Vendimmarrja dhe transparenca". Në këtë publikim janë përmbledhur të gjitha aktet ligjore që çuan në realizmin e këtij eventi si dhe një informacion të detajuar për ftesa, pjesëmarrjen dhe detaje të tjera në lidhje me Samitin e Dytë të Diasporës .

Materialin e plotë mund ta lexoni në linku-ne mëposhtëm: http://samiti.diaspora.gov.al/wp-content/uploads/2019/02/Vendimmarrja-dhe-Transparenca.pdf




## Agjencia Kombëtare e Diasporës marrëveshje bashkëpunimi me kompaninë prestigjoze "OC International"

Agjencia Kombëtare e Diasporës ka firmosur një marrëveshje bashkëpunimi për realizmin e aktiviteteve kulturore me kompaninë e drejtuar nga violinisti i mirënjohur shqiptar Olen Çezari.

Sipas kësaj marrëveshjeje të nënshkruar nga Drejtori i Agjencisë z. Dritan Delija dhe administratori i "OC International", Olen Çezari, të dy palët do të bashkëpunojnë për organizimin e eventeve, koncerteve dhe aktiviteteve kulturore në Diasporë me qëllim përhapjen e trashëgimisë kulturore dhe identitetit kombëtar.

Emri i artistit shqiptar me famë botërore do të jetë një garanci për nivelin e aktiviteteve që do të zhvillohen nga Agjencia Kombëtare Diasporës, ndaj pjesë e bashkëpunimit do të jetë edhe këshillimi i vazhdueshëm artistik nga "OC International", për aktivitete e parashikuara në programet vjetore të Agjencisë Kombëtare te Diasporës.




## Ministri i Shtetit për Diasporën, z.Pandeli Majko gjatë takimit me përfaqësues të Komisionit për Marrëdhëniet Ndërkombëtare dhe Emigrantëve të Parlamentit të Malit te Zi





